



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Legjislatura III
Sesioni Pranveror

Komisioni për Bujqësi, Pylltari, zhvillim Rural, Mjedis dhe Planifikim Hapësinor

Mbledhja nr. **65**

Prishtinë, më 23.2.2010, ora 13,00

Ndërtesa e Kuvendit, salla N-225

PROCESVERBAL

nga mbledhja e Komisionit

Në mbledhje morën pjesë: Naser Rugova, Naim Maloku, Zulfi Merxha, Heset Cakolli, Berat Luzha, Elheme Hetemi, Selvie Halimi, Myrvete Pantina, Ali Lajçi.

Mungoi : Dragiša Mirić, Zef Morina.

Të ftuarit dhe pjesëmarrësit tjerë : zyrtar, bashkëpunëtor, përfaqësues dhe vëzhgues të interesuar .

Nga stafi mbështetës i komisionit : Bajram Badivuku, Fjolla Cakuli.

Mbledhjen e kryesoi **Naser Rugova**, kryetar i komisionit.

Rendi i ditës:

1. Miratimi i rendit të ditës
2. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar dt. 9.2.2010,
3. Projektligji për shitjen e banesave (Zef Morina),
4. Të ndryshme.

1. Kryetari konstatoi se janë plotësuar kushtet për fillimin e mbledhjes, hapi mbledhjen për pikat e **rendit të ditës** dhe për disa çështje tjera, për të cilat nuk kishte vërejtje.

2. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar dt. 9.2.2010

Kryetari konstatoi miratimin e procesverbalit nga mbledhja e kaluar.

3. Projektligji për Shitjen e Banesave

Kryetari Naser Rugova konstatoi se deputeti Zef Morina nuk mund të jap sqarime pasi mungon, ndaj shkurtimisht njoftoi komisionin se i njëjti është ndarë i zhgënjyem nga mbledhja e fundit të komisionit për komunitete ku është i deleguar nga ky komision. Në fakt projektligji në fjalë ende prolongohet në këtë komision pa ndonjë arsye reale dhe nuk ka raport me shkrim. Ai kërkoi sugjerime nga anëtarët prezent të komisionit si të veprohet, pasi që nesër është mbledhja e përbashkët me Kryetarin e Kuvendit.

Naim Maloku sqaroi shkurtimisht për rëndësinë e këtij projektligji por tha se kjo nuk mund të jetë arsye për zhargitje të procedurës parlamentare. Ky ligj, vazhdoi ai, do të rregullonte problemet me afro 5000 banesa (kryesisht të ish-policëve etj) për të emëruar statusin e banesave në fjalë, në mënyrë që ato pastaj të blihen nga shfrytëzuesit. Komisioni për komunitete është i autorizuar vetëm të vërtetojë a ka shkelje të drejtave të komuniteteve dhe të sugjeroi ndonjë amendament ndërkaq që ende nuk e ka bërë këtë, ndërsa në anën tjetër kryesia në procedurën e rregullt nuk mundet një projektligj të tërheq pa pasur mbështetjen e komisionit funksional ose kryesorë (përpara këtë të drejtë e ka pasur edhe PSSP-ja). Ai sugjeroi kryetarit të komisionit që në mbledhjen e caktuar me Kryetarin e Kuvendit të kërkojë që administrata t'i drejtohet Qeverisë për të bashkëpunuar me komisionin për komunitete dhe të mirën vesh për më tutje si të veprohet, ku mund të sugjerohet nga komisioni të kthehet projekti por jo të zhargitet deri në pafund.

Elhame Hetemi kërkojë rigorozisht të zbatohet procedura e paraparë parlamentare, përndryshe komisioni që prolongon duhet të jap sqarime dhe bashkërisht këto sqarime të dërgohen në kryesi.

Heset Cakolli konstatoi se kemi të bëjmë për një ligj me shumë interes lidhur me disa banesa të mbetura pa status për të cilat duhet të mbrohen interesat e banesave, mirëpo ato duhet të menaxhohen e jo të mbeten kështu pa asnjë mbikëqyrje, dmth është koha e fundit të gjendet një rrugëdalje për këto banesa.

Selvie Halimi tha se ish sistemi ka bërë shitblerjen e këtyre banesave por kontestuese, ndërsa tani një komision qoftë ai edhe kryesori, nuk ka drejt të bllokoi procedurën jo më shumë se 2 muaj tërësisht, sa është e caktuar me rregullore, kurse vonesa është më tepër se dy vite. Ajo tha : “ne nuk kemi çka të kërkojmë nga komisioni për komunitete përpos të insistojmë që sa më shpejt të renditet për seancën plenare, sepse dikush si duket po ëndërron të përfitojë banesën duke u zhargit procedura”.

Zylfi Merxha tha se ai është anëtarë i komisionit të përfolur dhe vërtet nuk e ka të qartë pse prolongohet ky projekt ngase vetëm thuhet “ligj i keq” ndërsa nuk ka vërejtje konkrete. Ai vazhdoi : “Sanije Alijaj (kryesuesja e dytë) si duket spo guxon me vendos, ndërsa tre anëtarë tjerë të grupit punues në krye me Numan Baliq nuk po mujn me i dalë në skeep, minoritetët tjerë po thojnë që është ligj i keq por nuk tregojnë ku është i keq”.

Naser Rugova gjithashtu tha se ka kërkuar nga kryesuesja aktuale e komisionit znj. Sanije (në mungesë të kryetarit) me veprua konkretisht me këtë projektligj dhe të votohet, ndërsa **Myrvete Pantina** kërkojë zgjedhjen ta bëjë kryesia, në mënyrë që Kuvendi pastaj të vendosë.

Nexhat Shatri u mundua të sqaroi komisionit gjërat kontestuese për këtë projekt sepse si tha ai, ky ligj do të jetë i disfavorshëm në krahasim me ligjin e mëparshëm ngase tani mbajtësve që veç e kanë blerë një herë ju bien të paguajnë shumë më shtrenjtë (pensioneri tani duhet të paguaj afro 5000 euro), ndërsa juristët e dinë se ligji më i favorshëm duhet të aplikohet.

Naim Maloku sipas përvojës që ka pasur nga shtetet në rajon tha se këtu kemi të bëjmë edhe me qiranë ekonomike pas privatizimit të bërë, ngase privatizimi bëhet bashkë me asetete p.sh. PTK që cakton qiranë për banesat e privatizuar, ata që nuk kanë blerë, tash duhet të paguajnë këtë qira, që do të thotë se pronari i ri cakton qiranë.

Berat Luzha u angazhua për respektimin e procedurës parlamentare nga ana e komisionit për komunitete dhe të kaloi më tutje.

Kryetari **Naser Rugova** me pajtimin e komisionit nxori këtë :

K O N K L U D I M

Kryetari i Komisionit në mbledhjen e caktuar me Kryetarin e Kuvendit më 24.2.2010 do t'i përcjellë shqetësimet e këtij komisioni, si komision funksional, rreth projektligjit për Shitjen e Banesave, për të arritur një përfundim real nga instancat më të larta të Kuvendit.

4. Të ndryshme :

Ftesa për një punëtor në Dragash prej 2-4 mars

Kryetari Naser Rugova njoftoi se kemi të bëjmë me një punëtor që do të jetë me interes të veçantë për këtë komision dhe do të evidentohet nga administrata si takim i rregullt, ngase bëhet fjalë për parqet nacionale ndërkaq **Behar Xharra** më hollësisht njoftoi se bëhet fjalë edhe për konservimin, zhvillimin rural, florën dhe faunën, bimët endemike që janë në rrezik dhe për të cilat nuk ka studime etj. Kryetari sugjeroi administratorin të kontaktoi me Behar Xharren për shkuarjen e anëtarëve të komisionit në këtë punëtor dhe t'i lajmëroi për nisje etj.

Projektligji për Organizmat e Modifikuara Gjenetikisht

Kryetari tha se në seancën e së enjtes do të paraqes arsyetimin e tërheqjes së këtij projektligji sipas kërkesës së Ministrit Idriz Vehapi.

Ftesë nga ESTONIA

Kryetari njoftoi se është një ftesë e komisionit homolog për këtë komision nga Parlamenti Estonezë për një vizitë gjatë muajit prill të delegacionit prej 5 anëtarësh me ndihmën e mbështetjes nga OSCE (Blerim Vela). Komisioni u angazhua që deri 2 mars të ofroi emrat që do të shkojnë në Estoni me përpjekje të z. Blerim që këtij delegacioni ti shtohet edhe një anëtarë, ndërsa për administratorin u potencua se ai duhet të jetë në çdo vizitë pasi mosevidenca e vizitave të komisionit do të ishte e pakuptimtë. Në vizitat tjera do të aplikohet modeli i rrotacionit, por megjithatë në vizitën e ardhshme (Bruksel) do të shkohet komplet, ndërsa më tutje do të shikohet, tha në fund kryetari.

Elhame Hetemi njoftoi shkurtimisht për vizitën e kryer, ndërsa kryetari tha se kjo do të bëhet më gjerësisht në mbledhjen e radhës kur përgatitet edhe një raport i shkurtër nga deputetja, në bazë së cilës procedohet më tutje.

Mbledhja e komisionit përfundoi në orën 14,10. Mbledhja-takimi e radhës do të mbahet më 2.3.2010 në Dragash.

Kryetari i Komisionit,
Naser Rugova